



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 21.3.2018, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani dhe Sërgjan Mitroviq.

Nga stafi i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se nga mbledhja plenare e Kuvendit është propozuar një ndryshim teknik në amendamentin, nr. 1 të Komisionit në Projektligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, i miratuar në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018. Ky ndryshim teknik, tha se ka të bëjë me amendamentin nr. 1, në nenin 3, ku paragrafi 2 i nenit 3 duhet të jetë pika 1.3 e paragrafit 1 dhe e lexoi propozimin e amendamentit me tekstin si vijon:

1. Pjesë përbërëse e këtij Ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datën 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanović, e datës 16.2.2018.

1.3. Dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Kryetarja e komisionit, konstatoi se anëtarët e komisionit njëzëri vendosen që të votohet propozimi për ndryshimin teknik të amendamentit, pa debat paraprak.

Pasi e hodhi në votim propozimin për ndryshimin teknik të amendamentit 1, që ka të bëjë me nenin 3 të Projektligjit dhe pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

P e r f u n d i m

Ti rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr.06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, me amendamentin e propozuar nga Komisioni:

Amendamenti 1

Neni 3 i Projektligjit ndryshohet si vijon:

Neni 3

1. Pjesë përbërëse e këtij Ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datën 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanović e datës 16.2.2018.

1.3. Dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Përfundimi u nxor njëzëri, nga të pranishmit në komision.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu